

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë (UMT), mbetet zgjedhja e parë e maturantëve që duan të ndërtojnë një karrierë në fushën e Shkencave Mjekësore. Interesi i lartë i të rinjve për t'u bërë pjesë e UMT-së lidhet me cilësinë e lartë akademike, garancinë për punësim, si dhe mundësitë e shumta për vijim të studimeve në ciklet pasuniversitare.

1. Pse preferojnë maturantët të studiojnë Shkencat Mjekësore?

Shkencat Mjekësore janë më shumë se një degë studimi: ato përfaqësojnë një prej misionëve më të hershme të dijes njerëzore – kujdesin për jetën dhe shëndetin.

Në të njëjtën kohë, Shkencat Mjekësore përfaqësojnë një profesion me perspektivë të qëndrueshme dhe kërkesë të lartë në tregun e punës. Studentët e këtyre programeve fitojnë njohuri të avancuara teorike dhe praktike, akses në laboratorë të specializuar dhe mundësi për formim të vazhdueshëm në ciklet pasuniversitare. Kombinimi i traditës akademike, standardeve etike dhe përgatitjes profesionale bën që kjo fushë të mbetet një nga më të vlerësuarat dhe më të kërkuarat në Shqipëri.


2. Shifrat e aplikimeve në UMT për 3 vitet e fundit.

Gjatë tre viteve të fundit akademike (2023–2026), Universiteti i Mjekësisë, Tiranë ka patur një trend të qëndrueshëm dhe të lartë në numrin e aplikimeve, duke reflektuar interesin e vazhdueshëm të maturantëve për programet e tij të studimit. Numri total i aplikimeve ka qënë mbi 20,000 çdo vit (21,694 në 2023–2024, 20,874 në 2024–2025 dhe 21,671 në 2025–2026), ndërsa numri i aplikantëve unikë është ruajtur në nivele të qëndrueshme, rreth 7,300–7,500. Në të njëjtën linjë, kuotat e pranimi kanë patur një rritje të lehtë nga 1,588 në vitin 2023–2024 në 1,647 për vitin 2025–2026, duke reflektuar rritjen e kapaciteteve dhe nevojat e sistemit shëndetësor. Ky trend tregon jo vetëm qëndrueshmëri në interesin për studimet në shkencat mjekësore, por edhe përkushtimin institucional për të garantuar cilësinë dhe menaxhimin e balancuar të ofertës akademike.


Këtë vit akademik, krahasuar me vitin akademik 2024-2025, janë:

- | | |
|------------------------------|-----|
| • Aplikime në total më shumë | 797 |
| • Aplikant UNIK më shumë | 29 |
| • Kuota më shumë | 23 |

Në grafikun e mëposhtëm paraqiten të dhëna zyrtare krahasuese të aplikantëve sipas programeve të studimit në UMT, gjatë tre viteve të fundit akademikë.



Në grafikun e mëposhtëm paraqiten të dhëna zyrtare krahasuese të kuotave sipas programeve të studimit në UMT, gjatë tre viteve të fundit akademikë.



3. Cilësia e maturantëve që zgjedhin UMT dhe kriteret e pranimit

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë (UMT) garanton cilësinë e studentëve të rinj përmes një procesi pranimi të ndërtuar mbi kriteret e qarta dhe objektive akademike. Në thelb të këtij procesi qëndron vlerësimi i

performancës së maturantëve, ku prioritet kanë ata me rezultate të larta në gjimnaz dhe në provimet e Maturës Shtetërore.

UMT është i vetmi institucion i arsimit të lartë në vend që, përtej pragut minimal të përcaktuar me VKM nr. 436, datë 03.06.2020 (nota mesatare ≥ 6.5), ka vendosur kufij më të lartë hyrës për secilin program studimi.

Kështu, për programet e integruara të ciklit të dytë dhe për programet e ciklit të parë, nota mesatare, si kriter në hyrje, është si më poshtë:

- Mjekësi e Përgjithshme ≥ 8.5
- Farmaci ≥ 8.5
- Stomatologji ≥ 8.5
- Shëndet Publik ≥ 8
- Infermieri e Përgjithshme ≥ 7.5
- Fizioterapi ≥ 7.5
- Mami ≥ 7.5
- Teknikë Imazherie ≥ 7.5
- Teknikë Laboratori ≥ 7.5
- Logopedi ≥ 7.5
- Teknikë Dentare ≥ 7
- Higjienist Dentar ≥ 7

Për pranimet në programin “Mjekësi e Përgjithshme”, është përcaktuar dhe testimi i informatizuar në biologji, kimi dhe fizikë si komponent shtesë ku:

70% e peshës zënë rezultatet nga arsimi i mesëm dhe 30% pikët nga testi.

Këto masa dëshmojnë përkushtimin e UMT-së për të ruajtur standarde të larta akademike dhe për të përgatitur profesionistë të kualifikuar në shërbim të shëndetit publik.

4. Testimi i informatizuar për pranimet në programin “Mjekësi e Përgjithshme”, pranë QSHA


Viti akademik 2025-2026 është viti i tretë radhazi që procesi i pranimi në programin “Mjekësi e Përgjithshme” pranë Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, zhvillohet përmes testimit të informatizuar, duke garantuar transparencë dhe objektivitet.

Në vitin akademik 2025-2026, në programin Mjekësi e Përgjithshme kanë aplikuar gjithsej 2029 maturantë, nga të cilët 1202 maturantë priten të marrin pjesë në testimin e informatizuar, i cili përfundon në datën 22 gusht 2025. Testimi i informatizuar zhvillohet pranë QSHA dhe realizohet në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe UMT “Për testimin e informatizuar...”, si dhe Urdhrit nr.183, datë 01.11.2022 “Për miratimin e rregullores për procedurat...” të MAS.

Ndryshe nga vitet e mëparshme, këtë vit procesi i regjistrimit për testimin e informatizuar është zhvilluar përmes portalit e-Albania, duke sjellë më shumë efikasitet, transparencë dhe lehtësi për aplikantët.

Fondi i pyetjeve për testimin e informatizuar ne kuadwr tw pranimeve ne programin Mjekësi e Përgjithshme, publikohen dhe administrohen nga Qendra e Shërbimeve Arsimore, duke përfshirë lëndët kryesore si biologji, kimi, dhe fizikë.

Në grafikun e mëposhtëm paraqiten të dhëna zyrtare krahasuese të aplikantëve dhe pjesëmarrësve në testimin e informatizuar për programin “Mjekësi e Përgjithshme” gjatë tre viteve të fundit akademikë.



5. Ligji për studentët dhe punësimi i garantuar (risi këtë vit zbatimi i tij)

Ligji nr. 60/2023 “Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e Përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë”, i ndryshuar, i cili i shtrin efektet në periudhën nga viti akademik 2025-2026 deri në vitin akademik 2029-2030, synon të krijojë një lidhje më të ngushtë midis arsimit të lartë në fushën e mjekësisë dhe nevojave të sistemit shëndetësor publik.

Ky ligj parashikon trajtim të veçantë për ata studentë të cilët pranojnë/ndjekin studimet në programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e Përgjithshme” dhe nënshkruajnë marrëveshje para fillimit të vitit akademik përkatës dhe për të gjithë periudhën e kohëzgjatjes së studimeve me ministrinë përgjegjëse për arsimin, ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë dhe institucionit të arsimit të lartë publik, që pas përfundimit të studimeve të punojnë në profesionin e mjekut në institucionet shëndetësore në RSH për jo më pak se 3, 2 ose 1 vit (në varësi të vitit në të cilin studenti nënshkruan marrëveshjen).

Si pjesë e këtij angazhimi, Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale garanton punësimin e tyre sipas nevojave të institucioneve shëndetësore dhe koha e kryerjes së procedurës për punësimin e mjekut nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë është brenda 3 (tre) muajve nga momenti i lindjes së të drejtës për punësim. Në rast se punësimi nuk realizohet në këtë afat, parashikohet një kompensim financiar i përkohshëm për studentin.

Nëpërmjet sigurimit të burimeve njerëzore për kryerjen e shërbimeve të shëndetit publik në institucionet shëndetësore të vendit, ky ligj synon të sigurojë kthimin e investimit publik në formën e shërbimeve shëndetësore, duke ruajtur një raport të drejtë dhe të balancuar që respekton të drejtën e zgjedhjes profesionale të studentëve dhe njëkohësisht, ofron garanci të qarta për punësim pas diplomimit.

6. Stafi akademik i UMT

Cilësia e stafit akademik (me kohë të plotë) në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, përfaqëson një nga pikat më të forta të institucionit, duke u mbështetur në një trupë të kualifikuar dhe me përvojë të lartë profesionale.

Referuar të dhënave lidhur me kualifikimin e personelit akademik të **Fakultetit të Mjekësisë rezulton se 96% prej tyre janë me tituj akademikë dhe grada shkencore**, ku:

- 41% e personelit akademik kanë Titullin Akademik “Profesor”,
- 39% e personelit akademik kanë Titullin Akademik “Profesor i Asociuar”,
- 16% e personelit akademik kanë Gradën Shkencore “Doktor”
- 4% e personelit akademik janë “Lektorë”.

Fakulteti i Mjekësisë ka specifikën e vet në angazhimin e personelit të strukturave shëndetësore universitare në mbështetje të procesit të mësimdhënies, ku i gjithë personeli i rrjetit spitalor universitar është potencialisht i angazhuar në proceset e mësimdhënies, sipas përcaktimeve në statutin e UMT. Gjithashtu pranë Fakultetit të Mjekësisë janë angazhuar në procesin e mësimdhënies dhe personel akademik me kohë të pjesshme.

Referuar të dhënave zyrtare të Fakultetit të Mjekësisë, Dentare, **rezultojnë se 95% e personelit akademik janë me tituj akademikë dhe grada shkencore**, ku:

- 19% e personelit akademik kanë Titullin Akademik “Profesor”,
- 33% e personelit akademik kanë Titullin Akademik “Profesor i Asociuar”,
- 43% e personelit akademik kanë Gradën Shkencore “Doktor”
- 5% e personelit akademik janë “Lektorë”.

Në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike **rezultojnë se 92% e personelit akademik janë me tituj akademikë dhe grada shkencore**, ku:

- 8 % e personelit akademik kanë Titullin Akademik “Profesor”,
- 35 % e personelit akademik kanë Titullin Akademik “Profesor i Asociuar”,
- 49 % e personelit akademik kanë Gradën Shkencore “Doktor”
- 8% e personelit akademik janë “Lektorë”.

7. Lidhja e të diplomuarve që mbarojnë ciklin e parë apo program të integruar me ofertën akademike në vijim që ofron UMT.

Gjatë vitit akademik të fundit të raportuar, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë ka ofruar një strukturë të gjerë dhe të mirëorganizuar programesh studimi në të gjitha ciklet, në përputhje me strategjinë kombëtare të zhvillimit të profesionistëve të shëndetësisë.

Oferta akademik e UMT është si më poshtë:

- 9 programe të ciklit të parë (Bachelor),

- 3 programe të integruara të ciklit të dytë (Mjekësi, Farmaci, Stomatologji),
- 9 programe Master Profesional
- 7 programe Master Shkencor
- 37 shkolla specializim afagjatë
- 13 programe doktoratë
- 2 programe doktorata të përbashkëta
- 1 program Master Ekzekutiv

Për herë të parë në vitin akademik 2024–2025 është aktivizuar edhe programi Master Ekzekutiv në Kirurgji Pediatrike, duke reflektuar angazhimin për t'iu përgjigjur nevojave për nënspecialitete. Të gjitha programet rishikohen periodikisht dhe përmbushin standardet evropiane dhe shtetërore të cilësisë, duke ofruar përmbajtje të strukturuar në lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore dhe praktika klinike, në funksion të përgatitjes së plotë akademike dhe profesionale të studentëve.

8. Doktorata

Lidhur me realizimin e kuotave në programet e ciklit të tretë të studimeve, Doktoratë, në nivel universiteti:

Viti akademik 2023-2024:

- Numri i kuotave të miratuara: 219
- Numri i kuotave të realizuara: 204
- Përqindja e realizimit: 93%

Viti akademik 2024-2025:

- Numri i kuotave të miratuara: 203
- Numri i kuotave të realizuara: 197
- Përqindja e realizimit: 97%

Ky nivel realizimi dëshmon për një interes të lartë dhe një menaxhim efektiv të procesit të pranimeve në programet e doktoratës për 2 vitet e fundit akademike.

9. Bashkëpunimi me MSH dhe me MAS

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë (UMT) zhvillon veprimtarinë e tij akademike dhe formuese në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), si dhe me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (MAS), në funksion të garantimit të cilësisë dhe koordinimit institucional.

Një nga marrëveshjet kryesore me MSH-në lidhet me përfshirjen e Qendrës Shëndetësore Nr. 10, tashmë e kthyer në Qendër të Mjekësisë Familjare, në rrjetin e praktikës profesionale për specializantët e Mjekësisë së Familjes, duke mundësuar zgjerimin e bazës praktike për studentët.

Ndërkohë, në kuadër të marrëveshjes me MAS, është mundësuar zhvillimi i testimit të informatizuar për pranimin në programin Mjekësi e Përgjithshme pranë QSHA-së, proces që rregullohet me udhëzim të posaçëm të ministrisë dhe që për herë të parë është integruar edhe në platformën qeveritare e-Albania, duke i dhënë maturantëve mundësinë të aplikojnë në mënyrë të thjeshtuar dhe transparente për këtë program studimi. Këto marrëveshje pasqyrojnë angazhimin institucional për një sistem të integruar arsim-shëndetësi që i përgjigjet standardeve kombëtare dhe nevojave reale të tregut.